



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.453/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesat e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, Donjetë Morina nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHEN** si të palejuara ankesat ZL.A.nr.453/2017, ZL.A.nr.454/2017, ZL.A.nr.455/2017 dhe ZL.A.nr.456/2017, e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të Kamenicës, Donjetë Morina, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, të paraqitura me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar 4 (katër) ankesa nga Donjetë Morina, kandidatë për anëtare të Kuvendit Komunal të Kamenicës, nga radhët e subjektit politik PDK, me të cilat pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Qendrat e Votimit të Komunës së Kamenicës, si në: Koretin, vendvotimi 1024D/01R, 02R, 03R, 04R, në shkollën fillore "Andrea Durrsaku": 1001x/01, 02, 03, 04, 05D; 1001x/01, 02, 03, 04, 05D, në Rogaçicë, 1009D, 1009D/01R, 02R, 03R, 04D, në Topanicë: 1002D/01R, 02R, 03D.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.453/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

### Ankesat janë të pa lejuara

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkritazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, është marrë vendimi përfundimtar, mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hudh si të parakohshme

ankesat e ankuesit. Hudhja e ankesave të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitësa**

ZL. Anr.453/2017 më datën 24.10.2017



**Kryesuesi i Panelit  
Zyhdi Haziri**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*